

D E K R E T
Nr.1351, datë 23.1.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7832, DATË 16.6.1994 "PËR ÇMIMIN E TRUALLIT QË KOMPENSOHET"

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7832, datë 16.6.1994 "Për çmimin e truallit që kompensohet", në nenin 7 shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"Largësia nga brigjet ujore në bregdet e liqene dhe largësia nga rrugët kryesore të komunikimit, në brendësi të vendit".

Neni 2

Neni 8 të ndryshojë si vijon:

"Me miratimin e vijave kufizuese mbrojtëse të zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit dhe zonave për ndërtime turistike, duke përfshirë në to edhe trojet brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara të zonave përkatëse, duke u bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit të turizmit, me propozimin e Komitetit të Zhvillimit të Turizmit dhe miratim të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë bën klasifikimin e këtyre zonave në këto kategori:

- a) zonë e zhvillimit të turizmit të nivelit luks;
- b) zonë e zhvillimit të turizmit të nivelit të lartë;
- c) zonë e zhvillimit të turizmit të nivelit të mesëm."

Neni 3

Neni 9 ndryshohet si vijon:

"Çmimi bazë për truallin që ndodhet në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit luks, është 3200 lekë/m².

Për truallin që ndodhet në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit të lartë, çmimi bazë do të shumëzohet me koeficientin 0.5.

Për truallin që ndodhet në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit të mesëm, çmimi bazë do të shumëzohet me koeficientin 0.25.

Neni 4

Në nenin 10, në fjalinë e parë, pas fjalës "bashki" shtohet "dhe në rreth" dhe pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

"Kur qendrat e banuara ndodhen pranë brigjeve ujore, ndarja në zonë A dhe B do të përcaktohet mbi bazën e kriterit të largësisë nga brigjet ujore".

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

